

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 10 MARS 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja Zhupa,

Ju falënderoj për këtë interpelancë, sepse është në vazhden e aktiviteteve dhe masave që po marrim në Ministrinë e Arsimit, në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore për mbarëvajtjen e maturës shtetërore 2022. Edhe unë mendoj se ne nuk duhet të kujtohem pas provimeve të maturës, por duhet të zhvillojmë takime, debate, konsultime dhe të marrim të gjitha masat për të mos u përsëritur problematikat e shfaqura në vitet e kaluara. Për këto arsye, në muajin janar të këtij viti prezantuar rezultatet e maturës shtetërore të vitit 2021, sepse analiza e tyre na ndihmon jo vetëm ne si struktura politikbërëse, por edhe strukturat zbatuese, institucionet arsimore të marrim masa, së pari, të identifikohen problematikat, mangësitë, faktorët që kanë ndikuar në to, dhe, së dyti, të reflektojmë me të gjitha masat për minimizimin e këtyre problemeve, për rritjen e cilësisë së maturës shtetërore të vitit 2022, që nga hartimi i rregullores, edhe në çdo fazë të procesit, si hartimi i testeve, administrimi i procesit dhe vlerësimi i testeve.

Analiza që ne bëmë në nivel kombëtar me rezultate të përgjithshme natyrisht u pasua nga analizat në çdo zyrë arsimore në nivel bashkie, në nivel shkolle, por edhe për çdo lëndë, në mënyrë që edhe mësuesit, të cilët merren drejtpërdrejt me nxënësit për përgatitjen e provimeve të maturës, të marrin masat e duhura dhe të reflektojnë problematikat që u shfaqën nga viti i kaluar. Meqenëse përmendët uljen e kufirit të notës vitin e kaluar, dua të sjell në vëmendjen tuaj se viti shkollor 2020-2021 ishte tepër i vështirë për shkak të pandemisë së COVID 19. Janë aplikuar skenarët e mësimit të kombinuar, mësimi me turne, mësimi online, dhe pikërisht për këto arsye ne jemi përpjekur maksimalisht t'u qëndrojmë sa më pranë maturantëve. Madje, edhe në pikun më ekstrem të situatës së pandemisë, ne nuk e mbyllëm shkollën për asnjë moment për maturantët. Pra, edhe kur klasat e tjera bënë mësime online apo mësime të kombinuar, për maturantët përgjatë të gjithë vitit ne morëm masa që mësimi të zhvillohej me prezencë fizike në të gjitha shkollat e vendit.

Së dyti, për herë të parë vitin e kaluar, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore zhvilluan trajnime me nxënësit dhe mësuesit, sidomos të matematikës dhe letërsisë, meqenëse janë dy provimet më të rëndësishme, që kanë shfaqur edhe problematika në vite të ndryshme.

Së treti, përgatitëm programin orientues dhe modele testesh më shumë se çdo herë tjetër për t'i vënë në dispozicion të maturantëve dhe të mësuesve të tyre, që të përgatiteshin më shumë se vitet e tjera. Gjithashtu, zhvilluam interpelanca online, takime online dhe fizike me maturantët, me mësuesit dhe me prindërit, për t'i njohur me rregulloren, në mënyrë që ajo të zbatohet siç duhet dhe të parandaloheshin

shumë problematika. Pavarësisht masave të marra, jam dakord me ju, pas provimit të matematikës pati reagime, pati pakënaqësi, pati probleme vërtet, që ne na bënë të reflektojmë menjëherë duke mbledhur mësuesit, maurantët dhe ekspertët për të bërë një analizë të shpejtë të situatës. Reflektuam duke i vlerësuar të gjitha shqetësimet e maurantëve dhe të mësuesve, duke vlerësuar testet, duke marrë parasysh situatën e vështirë të pandemisë dhe me vendim unanim të Komitetit të Maturës Shtetërore, u vendos ulja e kufirit minimal të kalueshmërisë, por edhe të kufirit minimal për çdo notë.

Megjithatë, dua të theksoj se pavarësisht këtij problemi dhe të gjitha problemeve të tjera të shfaqura vitin e kaluar, kalueshmëria ka qenë shumë e lartë në të gjitha lëndët, 98%, dhe ka ardhur në rritje nga viti në vit. E dyta, aplikimi i metodës së korigjimit të pyetjeve me alternativa nëpërmjet sistemit kompjuterik ka rezultuar i suksesshëm, sepse shmang gabimet njerëzore gjatë vlerësimit, shkurton kohën e vlerësimit të testeve dhe në përgjithësi rrit cilësinë e korigjimit. Ndërkohë, nga muaji shtator i vitit të kaluar, Komiteti i Maturës Shtetërore ka punuar në mënyrë intensive për rregulloren e re të maturës 2022. Pasi u reflektuan gjetjet apo problematikat e hasura në vitin e kaluar, në shkurt ne prezantuam rregulloren e re gjatë një takimi me maurantët nga i gjithë vendi. Ju kujtoj se në komisionin e maturës shtetërore ka një përfaqësim shumë të gjerë të të gjitha institucioneve qofshin publike apo jopublike, duke filluar nga Ministria e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Rrjeti Akademik Shqiptar e kështu me radhë.

Më lejoni t'ju prezantoj disa nga ndryshimet që kemi bërë në këtë rregullore apo masat shtesë që kemi marrë për të parandaluar problematikat që janë shfaqur vitet e kaluara. Së pari, po organizojmë shumë më tepër trajnime në lidhje me rregulloren e maturës, testet, me mësuesit sidomos për programet orientuese, sepse ata do t'i ndihmojnë maurantët që të përgatiten në provimet e maturës. Gjithashtu, kemi marrë masa të kemi trajnim dhe certifikim për mësuesit që do të jenë pjesë e procesit. Dua t'ju kujtoj se jo çdo mësues mund të jetë pjesë e procesit të maturës shtetërore, por kemi vendosur kritere shumë të rrepta dhe të forta, që vetëm mësuesit me rezultate të larta, me një përvojë të gjatë në punë me maurantët dhe me integritet të lartë mund të jenë pjesë e këtij procesi.

Së dyti, meqenëse u konstatua se hartimi i testit ishte aspekti më problematik i të gjithë procesit, ne kemi vendosur që edhe hartimi i fondit të pyetjeve të bëhet në kushte të larta sigurie. Përzgjedhja e testit përfundimtar këtë vit, ndryshe nga vitet e kaluara, do të bëhet me metodën e Koepsit, duke garantuar kushte shumë të larta sigurie dhe mësuesit më të mirë që kemi në sistem, të përzgjedhur nëpërmjet një sistemi shumë të hapur dhe transparent.

Së treti, procesi i vlerësimit të testeve këtë vit do të mbikëqyret edhe nga grupe pune të ngritura nga Ministria e Arsimit, proces që është risi dhe një masë shtesë për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të maturës shtetërore në të gjitha aspektet e tij.

Së katërti, do të marrim masa që edhe vlerësimi i testeve të bëhet jo thjesht me cilësi të lartë, por edhe brenda një kohe të shkurtër, në mënyrë që t'u japim kohë edhe maurantëve që duan të studiojnë jashtë vendit, që t'i kenë në duar diplomat e tyre. Konkretisht, ne kemi vendosur dy data si afat: brenda datës 5 korrik maurantët që duan të studiojnë jashtë vendit do t'i kenë diplomat në duart e tyre, ndërsa

më 15 korrik është afati përfundimtar për të gjithë maturantët e tjerë. Së pesti, për sa u përket qendrave të provimeve, pra aty ku do të organizohen provimet, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, zyrat arsimore e drejtoritë rajonale, kemi marrë masa në mënyrë që të plotësojnë kriteret, të cilat janë të përcaktuara qartë në rregulloren e maturës shtetërore: të jenë të qeta, të pastra, të kenë hapësirat e duhura, të jenë të dezinfektuara, në mënyrë që maturantët gjatë procesit të provimit jo vetëm të punojnë të qetë, por dhe të japin maksimumin e tyre.

Së bashku me Qendrën e Shërbimeve Arsimore, ne do të vazhdojmë edhe në javët e ardhshme, edhe në muajt e ardhshëm, takime informuese, sensibilizuese, këshilluese, me maturantë, mësues e drejtues të institucioneve arsimore, për të garantuar që kjo rregullore jo vetëm të njihet, por dhe të zbatohet me përpikëri. Nuk është e vërtetë që janë bërë vetëm dy takime. Ndoshta për dy takime keni informacion ju. Ne nuk kemi mundësi që të gjitha takimet t'i publikojmë nëpër rrjetet tona sociale, por ju siguroj që kemi bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë shumë, sepse kjo është periudha më e rëndësishme. Ndërkohë, edhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, nga ana e saj, do të publikojë në faqen zyrtare jo vetëm programet lëndore orientuese, por edhe modele testesh apo çdo lloj informacioni tjetër për t'u ardhur në ndihmë si maturantëve, ashtu edhe mësuesve të tyre.

Ne po punojmë edhe për rishikimin e të gjithë procesit të maturës shtetërore, përfshirë edhe aktet nënligjore, nëpërmjet një grupi pune, i cili ka filluar që në muajin shtator dhe në fund të muajit mars do të na japë konkluzionet, gjetjet, nëse është e nevojshme të bëjmë dhe ndonjë ndryshim më të thellë. Ama, dua t'ju siguroj se, në çdo rast, nëse ne do të vendosim të kemi ndryshime më të mëdha, këto do të prezantohen në kohën e duhur; maturantët do të informohen në kohën e duhur, në varësi të ndryshimit; do të informohen që në klasën e dhjetë apo të njëmbëdhjetë, për t'u dhënë atyre dhe mësuesve të tyre të gjithë kohën e duhur për t'u përgatitur. Thënë këtë, në fund dua të theksoj edhe një herë që, pavarësisht problemeve që mund të kenë dalë vitet e kaluara, sistemi i maturës shtetërore është vlerësuar si i suksesshëm edhe nga institucione të pavarura; është një sistem që garanton meritën, preferencën e maturantëve, por edhe transparencën. Detyra dhe sfida jonë është ta zbatojmë këtë sistem me përpikëri, ta administrojmë sa më mirë, me cilësi dhe, pse jo, ta përmirësojmë aty ku është e nevojshme. Faleminderit!